



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 9093 Prot.

Lezhë, më 05 . 05 .2021

VENDIM

Nr. 89 Datë 30 . 04 . 2021

PËR

DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR BASHKIAK PËR VENDOSJEN E BARRIERËS ME RRJETA METALIKE NË AKSIN E RRUGËS KNALLË-SHËNGJIN.

Bazuar në Ligjin nr.139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 "Per funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020 "Për Pyjet", në Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433 datë 8.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të fondit pyjor e kullësor publik", ndryshuar me VKM nr 684 datë 02.09.2020", në VKM nr. 591, datë 9.10.2018, "Për disa ndryshime në VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat dhe paraqitjen e kërkesës, mbajtjen e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", në VKM nr. 592, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në VKM nr. 1374, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor" Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

V E N D O S I:

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor bashkiak, sipërfaqen pyjore që gjatë ndërtimit të elementëve të sigurisë do të preket nga vendosja e barriers me rrjeta metalike për pritjen e gurëve që mund të bien nga shpati i malit të Shëngjinit, në segmentin e aksit rrugor Knallë-Shëngjin.
2. Për ndjekjen e procedurave të mëtejshme ngarkohet Njësia e Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

